

VENDIM
Nr. 134, datë 11.11.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 31.10.2015, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË
ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO)”, VERSIONI 1.2**

Në bazë të neneve 16 dhe 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 112, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 16, pika 3, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.11.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST, sh.a. mbi vendimin nr. 131, datë 31.10.2015, të Bordit të ERE-s, “Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, versioni 1.2, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 131, datë 31.10.2015, “Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, versioni 1.2, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2 ndryshohet: “2. Efektet juridike të zbatimit të vendimit nr. 156, datë 1.12.2014, “Rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, janë ato të përcaktuara nga SEE CAO”;

b) Shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“Ankandet e kapaciteteve të interkonjeksionit për kufijtë, që janë të përjashtuara sipas procedurës së SEE CAO, për pjesën e mbetur të vitit 2015, OST, sh.a., duke filluar nga 31.10.2015, do t’i zhvillojë konform “Rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST, sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti